



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-05  
**Prokurori kundër Salih Mustafës**

**Vendos:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 29 prill 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Urdhër për komunikimin e versionit të paredaktuar të materialit provues**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të të Akuzuarit**  
Julius von Bone

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në pajtim me nenin 39(13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 95(2)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon urdhrin e mëposhtëm.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 9 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje Përkatëse (“Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave”), sipas të cilit, ndër të tjera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të marrë provat në formë të paredaktuar siç i janë nxjerrë palës marrëse.<sup>2</sup> Ky mekanizëm ka për qëllim t’i mundësojë Gjykatësit të Procedurës Paraprake të verifikojë sipas gjykimit të tij, vlefshmërinë e redaktimeve të zbatuara nga pala nxjerrëse dhe, nëse është nevoja, të urdhërojë palën nxjerrëse të heqë, pjesërisht ose plotësisht, çfarëdo redaktimi, pasi t’i ketë dëgjuar parashtrimet e saj.<sup>3</sup>

2. Më 5 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake caktoi datën për kalimin e dosjes së çështjes gjyqësore trupit gjykues, në pajtim me rregullën 98 të Rregullores, për të premtën, 7 maj 2021, ose rreth kësaj date.<sup>4</sup>

## II. DISKUTIM

3. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ZPS-ja nuk ia ka komunikuar ende Gjykatësit të Procedurës Paraprake versionin e paredaktuar të materialit provues

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-05, F00034, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje Përkatëse* (“Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave”), 9 tetor 2020, publik, para. 84, 90(o).

<sup>3</sup> Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave, para. 84

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 5 mars 2021 (“Transkripti i datës 5 mars 2021”), f. 203, rreshtat 4-6.

të nxjerrë sipas rregullave 102(1)(b),<sup>5</sup> 102(3) dhe 103 të Rregullores, siç përcaktohet në Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave. Duke mbajtur parasysh fazën e avancuar të procedurës paraprake<sup>6</sup> dhe datën e pritshme për kalimin e dosjes gjyqësore trupit gjykues, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në që brenda ditës së enjte, 6 maj 2021, të përmbushë kushtet e lartpërmendura të Vendimit Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave.

### III. VENDIMI

4. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake **URDHËRON** ZPS-në që brenda **ditës së enjte, 6 maj 2021**, t'i komunikojë Gjykatësit të Procedurës Paraprake versionin e paredaktuar të materialit provues të nxjerrë sipas rregullave 102(1)(b), 102(3) dhe 103 të Rregullores, në përputhje me paragrafin 84 të Vendimit Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Nikola Giju**  
**Gjykatës i Procedurës Paraprake**

E enjte, 29 prill 2021  
Hagë, Holandë.

---

<sup>5</sup> Kjo nuk vlen për materialin që i është nxjerrë Gjykatësit të Procedurës Paraprake në formë të paredaktuar sipas rregullës 102(1)(a) të Rregullores.

<sup>6</sup> Transkripti i datës 5 mars 2021, f. 184, rreshti 23 deri f. 185, rreshti 2.